



REPUBLIKA E SHQIPËRISE | AKU  
M.B.ZH.R.A.U  
Nr. 3572 Prot.  
Datë 04.09.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
MINISTRI

AKU  
K. Rishku Kodre  
OSSH Cuka  
Pjku Semi  
Laboratori Allkost

Nr. 6430 Prot.

Tiranë, më 31.8.2017 04/09/2017

**URDHËR**

Nr. 374, datë 31.8.2017

**PËR  
NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 72, DATË 15.03.2011, "PËR  
MIRATIMIN E AKT-KONTROLLIT "MBI INSPEKTIMIN E PRODUKTEVE  
USHQIMORE ME ORIGJINË JO SHTAZORE NË PIKAT E INSPEKTIMIT KUFITAR  
DHE LEJIMIN PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE TË MËTEJSHME PËR  
ZHDOGANIMIN E TYRE" DHE AKT "MARRJE-MOSTRE"**


Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, 41, nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar,

**URDHËROJ**

1. Në urdhrin nr. 72, datë 15.03.2011, "Për miratimin e Akt-Kontrollit "Mbi inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre" dhe Akt "Marrje-mostre", bëhet zëvendësimi i Akt-Kontrollit "Mbi inspektimin e produkteve ushqimore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre", me Akt-Kontrollin, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të njoftoj të gjitha subjektet importuese të produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore.
3. Ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi.





REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT  
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Tiranë, më \_\_\_\_ .2017

Nr. \_\_\_\_ Prot.

DREJTORIA RAJONALE E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

Qarku \_\_\_\_\_  
Seria \_\_\_\_\_

**AKT – KONTROLLI**

**Mbi inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore, në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre**

Sot, më datën \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_\_, në pikën e inspektimit kufitar \_\_\_\_\_, Z./Znj. \_\_\_\_\_, Inspektor i AKU-së në PIK, në zbatim të ligjit Nr. 9863, dt.28.01.2008, Për Ushqimin”, i ndryshuar, i ngarkuar dhe përgjegjës për kontrollin e procedurave të importit të produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore, konfirmon se ka kryer kontrollin fizik dhe dokumentacionin shoqërues si dhe përputhshmërinë e tij me produktin ushqimor si më poshtë:

1. Produktet ushqimore \_\_\_\_\_ (ton, kv, copë etj.)
2. Sasia \_\_\_\_\_
3. Origjina e mallit (vendi nga importohet) \_\_\_\_\_
4. Subjekti importues dhe adresa \_\_\_\_\_
5. Adresa e magazinimit të mallit pas çdoganimit \_\_\_\_\_

U konstatua:

A. Produkti ushqimor  është /  nuk është, me dokumentacionin e plotë teknik sipas kërkesave të ligjit Nr. 9863, dt.28.01.2008, Për Ushqimin”, i ndryshuar,  
Disponon / nuk disponon këto dokumente:

1. Certifikatën e origjinës \_\_\_\_\_
2. Raport analizën \_\_\_\_\_
3. Certifikatën fito-sanitare (sipas rastit) \_\_\_\_\_

B. Produkti ushqimor me origjinë jo shtazore  plotëson /  nuk plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi.

C. Nga kontrolli fizik, produkti ushqimor me origjinë jo shtazore  plotëson /  nuk plotëson kërkesat teknike të legjislacionit.  
Për sa më sipër, mbështetur në kërkesat e ligjit Nr. 9863, dt.28.01.2008, Për Ushqimin”, i ndryshuar  jam /  nuk jam dakord që të kryhen veprimet e mëtejshme nga organet doganore për zhdoganimin e mallit.

Ky akt-kontrolli ka vlerë për zhdoganimin e produktit ushqimor me origjinë jo shtazore. Subjekti, pronar i mallit ka të drejtë shitje të produktit ushqimor mbas përfundimit të analizave laboratorike.

Vërejtje \_\_\_\_\_

Ky akt- kontrolli mbahet në prani të përfaqësuesit të subjektit importues të produktit ushqimor, në katër kopje, nga të cilat një kopje (kopja e bardhë), i bashkëngjitet dokumenteve shoqëruese të mallit (deklaratës transit), një kopje (kopja e kuqe), e mban nëpunësi i doganës, një kopje (kopja e verdhë) e mban inspektori i AKU-së në PIK dhe një kopje (kopja jeshile) shoqëron mostrën.

**PERSONI PËRGJEGJËS**

**INSPEKTORI I AKU-së në PIK**